



Rekomandime për zbutjen e ndikimit të zhurmës nënujore mbi biodiversitetin detar në ujërat e detin Mesdhe të Evropës juglindore

Një workshop i rëndësishëm për “Zbutjen e ndikimit të zhurmës nënujore në biodiversitetin detar me fokus të veçantë në studimet sizmike në ujërat e Detin Mesdhe të Evropës Juglindore” u zhvillua në datat 22-23 Nëntor 2017, në Split, Kroaci. Në seminar diskutua mbi kompleksitetin e menaxhimit dhe zbutjes së zhurmës nënujore, dhe u zhvillua një set prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) Rekomandimesh prioritare, për të përmirësuar ruajtjen dhe mbrojtjen e kafshëve të egra detare në ujërat e Evropës Juglindore, nga kërcënimi i ndotjes nga zhurma detare.

Në workshop morën pjesë 65 pjesëmarrës nga 15 shtete (shih Shtojcën 1), që përfaqësonin grupe të ndryshme interesi. Ato përfaqësonin nga institucionet qeveritare si ministri, agjencitë e mbrojtjes, ruajtjes së natyrës dhe energjisë, deri te organizatat ndërkombëtare që përfshinin marrëveshje shumëpalëshe, rajonale, e mjedisore dhe organizatat rajonale të peshkimit, ekspertët dhe organizatat e shoqërisë civile. Pjesëmarrësit e ndoqën seminarin si përfaqësues privatë ose si vëzhgues dhe, ndërsa pjesëmarrja e tyre u mirëprit, u kuptua se rekomandimet që rrjedhin nga ky seminar nuk duhet të konsiderohen si detyruese mbi politikën e brendshme të organizatës.

16 rekomandimet e mëposhtme paraqesin rezultatet për të cilat u ra dakort gjatë takimit.

Autoritetet publike, industrisë dhe palëve të interesuara u kërkohet, sipas rastit:

Rekomandimi 1: Një Përfaqje Parandaluese

Zbatimi i një qasje parandaluese (si përfshirja në legjislacionin kombëtar, strategjitë) në aktivitetet e ardhshme që kanë potencial ose që janë të njohura për efektet e dëmshme në mjedisin detar,

Rekomandimi 2: Proçes Konsultativ Informal me afat i Kombeve të Bashkuara, mbi Oqeanet dhe Ligjin e Detit

Të sigurohet, në masën maksimale të mundshme, që Mbledhja e 19-të e Proçesit Konsultativ Informal me afat të Kombeve të Bashkuara, për Oqeanet dhe Ligji i Detit (ICP ose UNICPOLOS) në qershor 2018, të adresojë burimet e ndryshme të ndotjes së oqeanit nga zhurma, dhe të sigurojë udhëzime, si dhe një plan të qartë për veprimet zbutëse që mund të ndërmerren nga të gjithë aktorët e përfshirë.

Rekomandimi 3: Buxheti për Zhurmat

Shqyrtimi i konceptit të buxhetit/pragut të zhurmës për ujërat e Evropës Juglindore në detin Mesdhe, në përputhje me vlerat e nivelit të kërkuar sipas Direktivës Kuadër të Strategjisë Detare (MSFD).

Rekomandimi 4: Ndikimet kumulative

Adresimi i ndikimeve kumulative të të gjitha aktiviteteve në oqean, duke përfshirë ndryshimet klimatike, nëpërmjet strategjive shumësektoriale për politikën e energjisë, mjedisin dhe ekonominë blu të vendeve, veçanërisht përmes Planeve Hapësinore Detare, që do të zhvillohen nga Shtetet Anëtare të BE deri në vitin 2021¹.

¹ Direktiva 2014/89/BE e Parlamentit dhe Këshillit të Evropës, të 23 Korrik 2014, duke krijuar një kuadër për planifikimin hapsinor detar



Rekomandimi 5: Vlerësimet Strategjike Mjedisore (VSM) dhe Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis (VNM)

Vënia plotësisht në funksion e Vlerësimeve Strategjike Mjedisore shumë sektoriale (VSM) të drejtuara nga qeveritë, para se çdo zone të shpallet e hapur për të aplikuar për liçencë ushtrim aktiviteti në fushën e industrisë së naftës dhe gazit.

VSM-të dhe Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis (VNM), të cilat janë vlerësimet specifike për aktivitetet e propozuara, duhet të marrin parasysh të gjithë informacionin në dispozicion, për ndikimin e mundshëm në specie, habitate dhe përdorues të tjerë detarë (për shembull duke përfshirë praninë e habitatit të gjitarëve të detit, siç përcaktohet nga këshillat shkencore, të tilla si Zona të Rëndësishme të Gjitarëve të Detit), si dhe angazhimet legjislativ dhe jo legjislativ që janë të aprovuara (p.sh. Direktiva e Habitave të BE-së dhe Direktiva Kuadër e Strategjisë Detare të KE-së), si edhe duke marrë parasysh përfshirjen e komenteve kuptimplote dhe gjithë-përfshirëse, që vijnë nga dëgjuesat publike.

Informacioni që përmbajnë VSM-të të dhe VNM-të, si dhe të gjitha të dhënat e mbledhura duhet të jenë transparente dhe të disponueshme për të gjithë (p.sh., turizmi, peshkimi), duke përfshirë shoqërinë civile, në përputhje me rregulloret në fuqi. Informacioni mbi aktivitetet e kaluara, të tanishme dhe të planifikuara, që prodhojnë zhurmë, duhet të jenë të listuara në regjistrin kombëtar të zhurmave dhe të jenë në çdo kohë të aksesueshme për publikun.

Rekomandimi 6: Udhëzimet e VNM-së të Zhurmave të Konventës për Speciet Migratore (CMS)

Transpozimi i Konventës për Speciet Migratore (CMS) mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për Aktivitetet² që gjenerojnë Zhurmë në mjedise Detare (Udhëzimet e Konventës CMS mbi EIA), në legjisllacionin kombëtar ose në planet e menaxhimit të specieve, duke pasur parasysh kontekstin e strukturave ligjore kombëtare. Përdorimi i këtyre Udhëzimeve të Konventës CMS mbi VNM, si një format të standardizuar, detajon atë që pritet nga aplikuesit si dhe nga sistemi i vlerësimit. Udhëzimet duhet të përshtaten dhe të përmirësohen sipas këshillave të ekspertëve kombëtarë në kontekst gjithëpërfshirës. Nëse vendet nuk kanë një bazë ligjore për miratimin e udhëzimeve, parashkrimi i zhvillimit të direktivave të tilla mund të jetë një mjet i dobishëm.

Rekomandimi 7: Kufizimi i numrit dhe afateve kohore të vëzhgimeve sizmike

Kufizoni numrin dhe afatet kohore për vëzhgimet sizmike, për të shmangur praninë sezonale të llojeve vulnerabël si dhe dublikimin e vëzhgimeve. Shtetet duhet të përdorin plotësisht Konventën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis në një Kontekst Ndërkufitar (mekanizmat ESPOO) për konsultime ndërkufitare. Duhet të pasqyrohet një tablo reale e të gjitha aktiviteteve sizmike të planifikuara (për shembull, duke shfrytëzuar plotësisht regjistrin e zhurmave të MSFD), për të shmangur dublikimin e vëzhgimeve sizmike, si dhe për të përmirësuar konsultimet ndërkufitare.

Rekomandimi 8: Teknologjitë më të mira në dispozicion

Nxitja e zhvillimit dhe mandatimi i përdorimit të teknologjive më të mira në dispozicion si Marine Vibroseis, me anë të presionit rregullator si dhe duke kërkuar nga operatorët të tregojnë, që ata nuk po përdorin burime të cilat janë më të fuqishme sesa duhet si dhe në frekuenca të panevojshme. Kjo duhet të jetë një komponent i çdo VNM-je dhe të zbatohet gjatë vëzhgimit. Çfarëdo që konsiderohet e nevojshme duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit të pavarur, siç jepet i detajuar në Udhëzimet e Konventës CMS për VNM.

² <http://www.cms.int/en/document/adverse-impacts-anthropogenic-noise-cetaceans-and-other-migratory-species-0>



Rekomandimi 9: Aktivitetet e mëparshme, të njëkohshme, në vazhdimësi dhe të planifikuara

Merrni parasysh aktivitetet e mëparshme, të njëkohshme, në vijimësi dhe të planifikuara në të njëjtën zonë ose në zonat fqinje, për të shqyrtuar ndikimet e mundshme kumulative ose ndërvepruese, dhe për të vlerësuar efektivitetin e masave zbutëse dhe aktivitetet monitoruese për rishikimet para-operacionale, gjatë dhe pas operacionale, duke siguruar që rezultatet e monitorimit të jenë të aksesueshme nga publiku, siç është detajuar në Udhëzimet e Konventës së CMS për VNM.

Rekomandimi 10: Shqyrtimi i VSM-ve dhe VNM-ve

Të sigurohet, shqyrtimi korrekt i VSM-ve dhe VNM-ve për të ruajtur një ndarje transparente ndërmjet shkencës dhe politikës, si dhe për të shmangur konfliktet e interes tregëtar. Ky parim është detajuar brenda Udhëzimeve të Konventës CMS për VNM dhe mbështet dispozitat e Direktivës së BE-së 2011/92 / BE të ndryshuar nga 2014/52 / BE³. Duhet të programohet koha e përshtatshme, për të gjithë fazat e vlerësimit, duke përfshirë procesin e shqyrtimit dhe konsultimin me publikun.

Rekomandimi 11: Menaxhimi Hapësinor dhe i Zonës

Zhvillimi dhe përditësimi i hartave të integruara që tregojnë të gjitha Zonat e Rëndësishme të Gjitarëve të Detit (IMMAs) dhe zonat e mbrojtura detare të identifikuar nga organet kompetente dhe organizatat (për shembull autoritetet kombëtare, ACCOBAMS, CBD, GFCM, UNEP-MAP, NATURA 2000, IMMAs, EBSAs dhe të tjerë), për të lehtësuar menaxhimin hapësinor dhe të zonës, dhe për të siguruar që të gjitha llojet dhe habitatet me qëllim ruajtjen, të identifikuar nga këto organe, kanë nivelin e njëjtë dhe të duhur të identifikimit dhe njohjes, në përputhje me qëllimet e tyre të ruajtjes.

Rekomandimi 12: Subvencionet

Hiqni subvencionet për industrinë e naftës dhe gazit dhe shpenzoni fondet publike në përputhje me objektivat e Marrëveshjes së Parisit (2015) mbi Ndryshimet Klimatike.

Rekomandimi 13: Monitorimi i Zonave të Studimit

Marrja e të dhënave për praninë dhe shpërndarjen e specieve të ndjeshme ndaj zhurmave, të kërkuara për planifikimin hapësinor strategjik detar, sigurohet përmes inventarëve (për shembull Zonat e Interesit për Zonat e Rëndësishme të Gjitarëve Detarë, Zonat Ekologjike ose Biologjike të Rëndësishme Detare (EBSAs), dhe Zonat e Kufizuara të Peshkimit GFCM) për t'i dhënë përparësi se ku të fokusohet përpjekja dhe të monitorohen zonat e studimit; ku ka mungesë të njohurive rreth pranisë dhe shpërndarjes e specieve dhe habitateve të ndjeshme ndaj zhurmës.

Rekomandimi 14: Teknologjia më e mirë në dispozicion dhe praktika më e mirë mjedisore

Përgatitja e një raporti global mbi Teknologjinë më të mirë të Mundshme (BAT) dhe Praktika më e mirë Mjedisore (BEP) për zbutjen e zhurmës nënujore të shkaktuara nga aktivitetit njerëzor, dhe vendosja dispozicion për të gjitha agjencitë qeveritare, palët e interesuara dhe shoqërinë civile në rajonet në fjalë, si një shtesë të Udhëzimeve të Konventës CMS për VNM.

³ <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32014L0052>

⁴ <http://www.netccobams.com/>



Rekomandimi 15: Transferimi i njohurive

Shkëmbimi i njohurive dhe shkëmbimi i informacionit duhet të bëhen në nivel kombëtar (përfshirje multisektoriale) dhe në nivel rajonal (ndërmjet vendeve të ndryshme në rajon) dhe përmes një rrjeti të pavarur shkencor të hapur, i cili fokusohet në shpërndarjen e të dhënave dhe monitorimin e zhurmës në oqean, në Mesdhe. Mund të përdoret si një mjet për këtë, NETCCOBAMS platforma e zhvilluar nga ACCOBAMS.

Rekomandimi 16: Trajnimi dhe Kapaciteti

Adresoni në nivel rajonal, mungesën e trajnimeve dhe kapaciteteve (për shembull Vëzhguesit e Gjitarëve Detarë (MMO), Monitorimi Akustik Pasiv, etj.), duke përdorur iniciativa ekzistuese, siç është akreditimi i sistemit ACCOBAMS, për të pasur Vëzhgues të Gjitarëve Detarë të mirëtrajnuar, për të rritur ndjeshëm ndërgjegjësimin dhe për të krijuar përkrahje për reduktimin e zhurmës në mjedisin detar.

Dhjetor 2017

Workshopi 2-ditorë u organizua dhe u mikprit nga OceanCare dhe NRDC, organizatat ndërkombëtare për ruajtjen e natyrës, si dhe u mbështet teknikisht dhe financiarisht nga Deutsche Bundesstiftung Umwelt (DBU).

SHTOJCA 1: Lista e pjesëmarrësve

| Mbiemri | Emri | Pozicioni/Institucioni | Vendi |
|-----------------|------------------|---|----------|
| Alexiadou | Paraskevi | Instituti i Kërkimeve për Balenat, Pelagos | Greqi |
| Ameri | Michele | Departamenti i Kombeve të Bashkuara për Çështjet e Oqeanit dhe Ligjin e Detit | Itali |
| Bataković | Milena | Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Natyrës | Mal i Zi |
| Bernal | Miguel | Komisioni i Përgjithshëm i FAO për Mesdheun (GFCM) | Spanjë |
| Bravo | Carlos | Aleanca Mar Blava | Spanjë |
| Carić | Dr Hrvoje | Instituti i Turizmit | Kroaci |
| Carpentieri | Serena | Legambiente Onlus | Itali |
| Čižmek | Hrvoje | Shoqata e Eksploruesve Detarë 20000 lega | Kroaci |
| Čović | Radosav | Administrata e Hidrokarbureve e Malit të Zi | Mal i Zi |
| D'Amato | Leonora | Autoriteti për Burimet dhe Mjedisin | Maltë |
| Dinkelmeyer | Andreas | Fondi Ndërkombëtar për Mirëqënien e Kafshëve (IFAW) | Gjermani |
| Dobrinić | David | Agjencia e Hidrokarbureve | Kroaci |
| Domel | Claudia | Deutsche Bundesstiftung Umwelt (DBU) | Gjermani |
| Đurović | Mirko | Drejtor i Institutit të Biologjisë Detare | Mal i Zi |
| ElHaweet | Alaa Eldin | Akademia Arabe për Shkencën, Teknologjinë dhe Transportin Detar | Egjipt |
| Entrup | Nicolas | OceanCare/NRDC | Austri |
| Ferri | Nicola | Komisioni i Përgjithshëm i FAO për Mesdheun (GFCM) | Itali |
| Frey | Silvia | OceanCare | Zvicër |
| Frisch- | Nwakanma Heidrun | Sekretariati UNEP/CMS | Gjermani |
| Holcer | Draško | Instituti Blue World | Kroaci |
| Janković-Mišnić | Jasmina | Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit | Mal i Zi |
| Jelenić | Ivana | Ministria e Mjedisit dhe Energjisë | Kroaci |
| Jelić | Katja | Agjencia Kroate për Mjedisin dhe Natyrën | Kroaci |

| Mbiemri | Emri | Pozicioni/Institucioni | Vendi |
|-------------------------|-------------|---|--------------|
| Jeremić | Jasna | Agjencia Kroate për Mjedisin dhe Natyrën | Kroaci |
| Kandić | Milica | Green Home | Mal i Zi |
| Knežević | Jelena | UNEP/MAP | Mal i Zi |
| Kramer | Brigitte | Gazetar privat | Gjermani |
| Kruss | Aleksandra | Instituti i Shkencave Detare CNR Venecia, Itali | Poloni |
| Leaper | Russell | Fondi Ndërkombëtar për Mirëqënien e Kafshëve (IFAW) | Angli |
| Lüber | Sigrid | OceanCare | Zvicër |
| Mackelworth | Peter | Instituti Blue World | Angli |
| Madricardo | Dr Fantina | Instituti i Shkencave Detare CNR | Itali |
| Maglio | Alessio | SINAY | Itali |
| Matea | Spika | Udruga Sunce | Kroaci |
| Mateja | Gazic | Ministria për Mbrojtjen e Mjedisit | Kroaci |
| Medenica | Nikola | Agjencia e Malit të Zi për Mbrojtjen e Mjedisit (EPA) | Mal i Zi |
| Micallef | Tamara | Autoriteti i Burimeve dhe Mjedisit | Maltë |
| Michaelides | Savvas | Departamenti i Peshkimit dhe Kërkimit Detar | Qipro |
| Müller | Johannes | OceanCare/NRDC | Gjermani |
| Nenadović | Tina | Departamenti i Mjedisit dhe Jetës së Egër Detare, Gardline Geosurvey Ltd. | Kroaci |
| Nikolić | Vedran | Drejtoria e Përgjithshme për Mjedisin, Komisioni European | Kroaci |
| Notarbartolo di Sciarra | Giuseppe | Instituti i Kërkimeve Tethys | Itali |
| Panigada | Simone | ACCOBAMS | Itali |
| Panou | Aliki | Archipelagos – mjedis dhe zhvillim | Greqi |
| Pavan | Gianni | Universiteti i Pavia | Itali |
| Pilikou | Maria | Këshillues ligjor – Ligjet Ndërkombëtare për Detin | Qipro |
| Radojčić | Dušica | Shoqata e Gjelbër Istria | Kroaci |

| Mbiemri | Emri | Pozicioni/Institucioni | Vendi |
|----------------|-------------|--|-----------------|
| Radonjić | Dina Skarep | Administrata për Hidrokarburet e Mali të Zi | Serbi |
| Radović | Ilija | Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit (EPA) | Mal i Zi |
| Raičević | Nikola | Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit (EPA) | Mal i Zi |
| Rako Gospić | Nikolina | Instituti Blue World | Kroaci |
| Risch | Denise | Shoqata Skoceze për Shkencat Detare | Gjermani |
| Ritter | Fabian | Mbrojtja e Delfinëve dhe Balenave (WDC) | Gjermani |
| Schneider | Daniela | Agencies Kroate për Mjedisin dhe Natyrën | Kroatia |
| Sekovski | Ivan | Programi i Aksioneve Prioritare/Qendra e Aktiviteteve Rajonale (PAP/RAC) | Kroaci |
| Sijan | Milena | Moderator | Kroaci |
| Šimunović | Vedran | Udruga Val | Kroaci |
| Širović | Dr. Ana | Instituti Scripps i Oqeanografisë | Kroaci/ShBA |
| Štrbenac | Ana | Zyrë këshillimore / Stenella consulting d.o.o. | Kroaci |
| Summer | Lisinka | OceanCare | Austri |
| Tomac | Luka | Zelena akcija / FoE Kroaci | Kroaci |
| Tomić | Zoran | Greenpeace për vendet e Evropës QJL në Kroaci | Kroaci |
| Vaniček | Dr Vlatka | Drejtor i Sektorit për Mbrojtjen e Mjedisit | Kroaci |
| Varda | Dušan | Qendra e Mesdheut për Monitorimin Mjedisor - MedCEM | Serbi |
| Weilgart | Linda S. | Universitetit Dalhousie, Departamenti i Biologjisë | SHBA & Gjermani |